



Datë: 11.03.2026  
Numër Protokolli: 1274/2026

A.nr.1825/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, Merlinda Ramaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1825/2025, të datës 22.10.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.G kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.03.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**Përfundon procedimi administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1825/2025, të datës 22.10.2025, e parashtruar nga ankuesi A.G.

## A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil A.G.(në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesi*), më datë 31.07.2025, përmes postës elektronike [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017446, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Shfrytëzim të Qëndrueshëm të Resurseve Natyrore, të shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më datë 25.03.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritori administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6926/2025, të datës 22.10.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Njoftimin e datës 21.05.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.10.2025; Përgjigjen në ankesës të datës 05.11.2025; Njoftimin e datës 20.05.2025; Njoftimin për kandidatin fitues të datës 23.09.2025; Listën për kandidatët fitues të datës 23.09.2025; Pyetjet e intervistës me gojë të datës 19.06.2025; Formuluarin e vlerësimit individual të intervistës me gojë të anëtarëve të Komisionit të datës 19.06.2025; Njoftimin e datës 16.06.2025; Njoftimin e datës 11.06.2025; Testin me shkrim të datës 02.06.2025; Çelësin e esesë; Njoftimin e datës 29.05.2025; Vendimin me numër protokolli Nr.4288/25, të datës 29.05.2025; Vendimin Nr.4282/2025, të datës 29.05.2025; Akt emërimit me Nr.06/2023, të datës 20.04.2023; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit AF/02, të datës 07.03.2018; Akt emërimit të datës 19.05.2014; Njoftimin e datës 22.05.2025; Listën e kandidatëve (të refuzuar dhe aprovuar); Aplikacionin me datë aplikimi 24.04.2025 të kandidatës A.B së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 28.03.2025 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Vendimin Nr.3771/2025, të datës 08.05.2025; Konkursin me numër reference RN00017446, Vendimin A.nr. 1744/2025, të datës 10.11.2025.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezultojnë se:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 25.03.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00017446, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Shfrytëzim të Qëndrueshëm të Resurseve Njerëzore, një vend i lirë pune, me klasë të pozitës Profesional 1, me afat aplikimi nga data 26.03.2025 deri më datën 24.04.2025.
- Ankuesi ka aplikuar në konkursin përkatës të punësimit, mirëpo, të njëjtit me njoftimin e datës 21.05.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se : Ju nuk mund të vazhdoni në procedurë për pozitën : Zyrtar i Lartë për Shfrytëzimin të Qendrueshëm të Resurseve Natyrore me Nr. refnce; RN00017446, për arsye se nuk i keni plotësuar kriteret e konkursit sa i përketë përvojës së punës, asi që dokumentacioni i bashkangjitur tek punëdhënësi Q.D.T Elita Plus është i mangët (kontratat e prezantuara në aplikacion janë të panënshkruara).
- Më datë 23.09.2025, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka publikuar Njoftimin për kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezultojnë se kandidatja A.B me 87.8 pikë, është shpallur si candidate fituese për pozitën përkatëse.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton konkursin numër reference RN00017446, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Shfrytëzim të Qëndrueshëm të Resurseve Njerëzore, mbi pretendimin ankimor se i njëjti është përcjellë me shkelje ligjore, sepse fillimisht më është pranuar dokumentacioni për verifikimin paraprak, pastaj me njoftimin e datës 21.05.2025 me është refuzuar aplikacioni. Shton se kontrata e punës janë përcjell pa nënshkrime si pasojë e mos ngarkimit të tërë dokumentit.

Tutje, nga shkresat e lëndës del së ndaj procedurës e rekrutimit me Nr. Reference: RN00017446, ka parashtruar ankesë më datë 29.09.2025, edhe kandidati R.R, ndërsa, Këshilli më Vendimin A.nr. 1747/2025 të datës 10.11.2025, ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit më Nr. Ref: RN00017446.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1825/2025, të datës 22.10.2025, ka të bëjë me procedurën e njëjtë të pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1747/2025, të datës 10.11.2025, rrjedhimisht, ka anuluar në tërësi këtë procedurë, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”, Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.1825/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

***Këshillë juridike:*** Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**A.nr.1825/2025**

**Merlinda Ramaj**

*Procesmbajtëse*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit, A.G;
- Ministritë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës:  
Sekretarit dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së